



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government*

REPUBLIKA-KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO  
MINISTRIA E PUSHTETIT LOKAL  
MINISTARSTVO LOKALNE SAMOUPRAVE  
MINISTRY OF LOCAL GOVERNMENT ADMINISTRATION

No. Sr. No. 020-880/7  
Data (Datum) 11.12.2020


<b>Për :</b>	<b>Lutfi Haziri, Kryetar i Komunës së Gjilanit</b> <b>Shpresa Kurteshi Emini, Kryesuese e kuvendit të Komunës së Gjilanit</b>
<b>Kopje:</b>	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Sekretari i Përgjithshëm i MEA-së
<b>Nga:</b>	<b>Trim Berisha, zv. Sekretar i Përgjithshëm në MPL</b> Datë: 10.12.2020
<b>Zyrtarët përgjegjës:</b>	<b>Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave</b> Nr.020-880
1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Komunë	<b>Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave</b>
2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse	<b>Driton Xhafa, Zyrtar për monitorim të komunave</b>
<b>Lënda:</b>	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Gjilanit
<b>Lloji i aktit:</b>	Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Kryetar,  
E nderuara Kryesuese,

Ministria e Pushtetit Lokal, ka pranuar Vendimin nr.016-105540 për modifikimin e attributeve të titullarit-pronarit të pronave komunale dhe regjistrimin e tyre në SIKTK me emërtime ligjore të kuvendit të komunës së Gjilanit, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit, dhe i nënshkruar nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Gjilanit, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.


Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni raportin e vlerësimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit.



Republika e Kosovës  
 Republika Kosova-Republic of Kosovo  
 Qeveria -Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit  
 Ministarstvo Ekonomije i Zivotne Sredine  
 Ministry of Economy and Environment



Për :	Goran Rakič, Ministër në MAPL Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Blerim Kuçi, Ministër i MEA Fatos Qerimi, Sekretar i Përgjithshëm i MEA
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit
Lloji i aktit:	Vendimi Nr.016-105540 për modifikimin etributeve të titullatit-pronarit të pronave komunale dhe regjistrimin e tyre në (SIKTK) me emërtimin ligjor: Komuna e Gjilanit, miratuar nga KK Gjilan.

I nderuar Minister,  
 E nderuar Sekretare,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Rregulloren (QRK) Nr. 07/2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti

Ligjor i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi Nr.016-105540 për modifikimin etributeve të titullatit-pronarit të pronave komunale dhe regjistrimin e tyre në (SIKTK) me emërtimin ligjor: Komuna e Gjilanit, miratuar nga KK Gjilan.

I miratuar me datë: 09.11.2020

I parashtruar për shqyrtim në MPL me datë: 11.11.2020

I dërguar për shqyrtim në MEA, me datë: 20.11.2020

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit – Agjencioni Kadastral i Kosovës, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, ju njofton se për rastet konkrete jemi në procedurë e sipër për unifikimin e emrave të pronarëve të njëjtë të regjistruar me emra të ndryshëm në regjistër kadastral.

Agjencioni Kadastral i Kosovës, me datë 10.11.2020, ju është drejtuar me shkresë të gjitha komunave, ku i njofton se AKK është duke e bërë korrigjimin dhe plotësimin e të dhënave për personat fizik dhe juridik, të cilët janë të regjistruar në Regjistrin e të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme (RDPP) si pronarë, shfrytëzues ose me të drejt qirambajtje. Në mesin e të dhënave për plotësim dhe korrigjim janë edhe të dhënat për pronar apo shfrytëzues, të regjistruar në regjistrin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme në emër të Komunave.

Andaj, ky proces do të përfundohet nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) për të gjitha Kuvendet Komunale, po ashtu, edhe për Komunën e Gjilanit.

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, mbetet në dispozicion të MAPL dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

#### Vërejtje:

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, konstatoi se Vendimi Nr.016-105540 për modifikimin etributeve të titullatit-pronarit të pronave komunale dhe regjistrimin e tyre në (SIKTK) me emërtimin ligjor: Komuna e Gjilanit, miratuar nga KK Gjilan, është miratuar, me datë 09.11.2020, ndërsa, e njëjta është proceduar në MPL, me datë 11.10.2020, kurse MPL, po të njëjtin akt e ka përcjellur në MEA, me datë 20.11.2020

Andaj, si e tillë, akti i përcjellur nga MPL në MEA, është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 9 paragrafi 2 nenparagrafi 2.1 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, ku shprehimisht thuhet: "Ministria, jo më vonë se dy (2) ditë nga data e pranimit të aktit të komunës, me shkresë përcjellëse do të adresoj aktin në ministrinë përgjegjëse për shqyrtimin e ligjshmërisë".

